

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Refki Piraj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Njomëza Berisha, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh. K., për shkak të veprës penale të sulmit, nga neni 187 paragrafi 1 të KP-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore, në Prizren, PP/II.nr.1400/15 të datës 17.06.2015, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, gjykata jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 22.03.2018, merr këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari **SH. K.**, nga i ati N. dhe e ëma S., e lindur E., i lindur me datë , në Prizren, rruga", nr. ka të kryer shkollën fillore, me profesion kamarier, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë SHTË FAJTOR

Se me datë 25.04.2013 rreth orës 16:25 minuta në Prizren, rruga " ", me dashje e përdor forcën ndaj të dëmtuarit J. P. në atë mënyrë që për shkak të një mosmarrëveshjeje të mëhershme që kishte mes tyre rreth një borxhi, i dëmtuari gjersa ishte duke ecur rrugës, i pandehuri i cili ishte duke lëvizur me veturë e ndal veturën dhe del nga vetura duke e sharë të dëmtuarin pastaj e shtyn, ku nga forca e shtytjes i dëmtuari e godet me kokë shtyllën elektrike dhe është rrëzuar për tokë por nuk i shkakton lëndime të dukshme trupore.

Me këto veprime ka kryer veprën penale, të sulmit nga neni 187 par.1 të KPK-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 495 të KPPK-se, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti Përgjithshëm, për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.1400/15 të datës 17.06.2015.

Andaj, gjykata ne kuptim të nenit 4, 41, 43 par.1 pika 1.3, nenit 46, 73 dhe nenit 187 par.1 të KP-së, dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurit Shefeqet Kude, ia shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Në lartësinë prej 140 € (njëqind e katërdhjetë) euro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi me gjobë nuk realizohet as detyrimisht, atëherë gjykata konform nenit 46 par.3 të KP-së, dënimin me gjobë në lartësi prej 140 € do ta zëvendëson me dënim burgu në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) ditësh, ashtu që për çdo 20 € nga dënimi me gjobë do të llogaritet me 1 (një) ditë burgim.

I dëmtuari J. P. nga Prizreni, rruga , (), nr. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

I pandehuri obligohet që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20€, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Bazuar në nenin 39 parag. 3 pika 1 të Ligjit nr.05/L-036 , të akuzuarës i caktohen 30 euro taksë në emër të kompensimit të viktimave të krimit e cila obligohet që të i paguaj, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën me nr. PP/II.nr.1400/15 të datës 17.06.2015, kundër të pandehurit Sh. K. , për veprën penale të sulmit, nga neni 187 paragrafi 1 të KP-së, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoi kërkesën për dhënie e urdhrit ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të pandehurit do t'i shqiptoj dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas shiqimit të shkresave të lëndës dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, Gjyqtari i vetëm gjykues, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par.1 të KPP-se, në kuptim të nenit 495 par.1 të KPP-së dhe vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënie e urdhrit ndëshkimor.

Kjo gjykatë konsideron nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: raporti i oficerit me numër 2013 – GA – 0968 të datës 25.04.2013 të përpiluar nga oficeri Sh. K. , në deklaratën e të dëmtuarit dhe të pandehurit, u vërtetua se i njëjti e ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet, andaj gjykata ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar do të arrihet edhe qëllimi i dënimit, që në të ardhmen i pandehuri të mos kryej ndonjë vepër penale të paraparë me ligj.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par. 1 lidhur me paragrafin 2 të KPP-së.



Vendimi mbi paushallin gjyqësor u muar në kuptim të nenit 450 par. 2.6 dhe 451 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Vendimi për programin e kompenzimit të viktimave të krimit u muar në kuptim të nenit 39 parag.3 pika 1 të Ligjit me numër 05/L-036.

Me sa u tha më lartë, në kuptim të nenit 365 të KPP-se, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1236/15, me datë 22.03.2018

B. Profesional
Njomëza Berisha



UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën Themelore në Prizren. Nëse i pandehuri nuk parashtron kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formën e prerë.